

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” – PRISHTINË

## FAKULTETI JURIDIK

Tema: "Përparësitë dhe të metat e llojit të arbitrazhit ad-hoc në raport me ndërmjetësimin në zgjidhjen e kontesteve tregtare në Kosovë".

### ABSTRAKT

Tema: "Përparësitë dhe të metat e llojit të arbitrazhit ad-hoc në raport me ndërmjetësimin në zgjidhjen e kontesteve tregtare në Kosovë". Në këtë punim është trajtuar përkufizimi dhe historiku i llojit të arbitrazhit ad-hoc dhe ndërmjetësimit në zgjidhjen e kontesteve tregtare në Kosovë, roli dhe rëndësia e funksionimit të llojit të arbitrazhit ad-hoc dhe ndërmjetësimit. Rregullimi ligjor dhe funksionimi i llojit të arbitrazhit ad-hoc dhe ndërmjetësimit në zgjidhjen e kontesteve tregtare në Kosovë. Fokus të veçantë i është kushtuar hulumtimit lidhur më përparësitë dhe të metat e llojit të arbitrazhit ad-hoc në raport me ndërmjetësimin në zgjidhjen e kontesteve tregtare në Kosovë. Të përbashkëtat e llojit të arbitrazhit ad-hoc dhe ndërmjetësimit. Gjithashtu janë prezantuar të dhënat e realizuara nga pyetëtori dhe anketa për përparësitë dhe të metat e llojit të arbitrazhit ad-hoc në raport me ndërmjetësimin në zgjidhjen e kontesteve tregtare në Kosovë. Krejt në fund përfundimet dhe rekomandimet si dhe literatura.

Identifikimi i përparësive dhe të metave të llojit të arbitrazhit ad-hoc në raport me ndërmjetësimin në zgjidhjen e kontesteve tregtare në Kosovë, do të jetë një ndihmë e madhe për të gjitha llojet e shoqërive tregtare, në rend të parë të kenë njohuri për këta dy mekanizma alternativ, pastaj në veçanti për llojin e arbitrazhit ad-hoc, përparësitë dhe të metat e këtij lloji të arbitrazhit në raport me ndërmjetësimin në zgjidhjen e kontesteve tregtare. Në këtë mënyrë, në rast kontesti eventual në mes tyre si palë e kanë më lehtë që të vendosin se cilit mekanizëm t’ia besojnë zgjidhjen e kontestit.

Fjalët kyçe: Mekanizmat alternativ, Arbitrazhi ad-hoc, Ndërmjetësimi, Bizneset.

Kandidatja: Diellzë Llugaliu